

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

RREGULLORE E PUNËS SË KËSHILLIT DREJTUES TË UNIVERSITETIT TË SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

Ferizaj, 2021





UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
— FERIZAJ —

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. As. Dr. Samet Dalipi

Nr. Prot.: 144/21; Datë: 25.01.2021

Në bazë të nenit 19, paragrafit 1 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Këshilli Drejtues i UShAF, në mbledhjen e mbajtur me datën 25.01.2021, mori

V E N D I M


- I. Miratohet Rregullorja e Punës së Këshillit Drejtues të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.
- II. Rregullorja hynë në fuqi nga dita e miratimit të saj.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i UShAF për qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore në UShAF dhe harmonizimit të akteve të brendshme me Statutin e UShAF, pas elaborimit të draft rregullores në fjalë, në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Këshillit Drejtues të UShAF;
2. Arkivit të UShAF.



Prof. As. Dr. Samet DALIPI
Kryesuesi i Këshillit Drejtues



Në bazë të nenit 19, paragrafit 1 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Këshilli Drejtues (KD) i UShAF, në mbledhjen e mbajtur më 25.01.2021, miratoi:

RREGULLOREN E PUNËS SË KËSHILLIT DREJTUES TË UNIVERSITETIT TË SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës së KD të UShAF (thirrja dhe mënyra e mbajtjes së mbledhjeve, mënyra e vendosjes dhe zbatimi i vendimeve, si dhe çështjet e tjera përkatëse).
2. Rregullorja e Punës së KD miratohet me shumicën e votave të anëtarëve të KD.

II. VERIFIKIMI I MANDATIT TË ANËTARËVE TË KD

Neni 2

Mbledhjen konstituive të KD e thërret anëtari më i vjetër, nga përbërja e zgjedhur nga Senati, i cili e kryeson atë vetëm derisa të zgjedhet kryesuesi i KD.

Neni 3

- 1) Në mbledhjen e parë (konstituive), KD e verifikon mandatin e anëtarëve të KD, në bazë të raportit të Sekretarit të Përgjithshëm, në lidhje me rregullsinë e zgjedhjes së anëtarëve të KD nga Senati, si dhe emërimit të anëtarëve të KD nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), me propozim për verifikimin e mandatit.
- 2) Raporti votohet në dy pjesë, njëherë për anëtarët e zgjedhur nga Senati dhe njëherë për anëtarët e emëruar nga MASH.
- 3) Nëse KD konstaton se zgjedhjet dhe emërimet nuk janë bërë në mënyrë të rregullt ose nëse ekziston ndonjë konflikt interesi për një apo më shumë anëtarë të KD, atëherë i kërkon institucionit përkatës zgjedhjet apo emërimet e kontestuara brenda një periudhe prej dy javësh.
- 4) Në rast të kontestimit të zgjedhjeve apo emërimeve, mbledhja konstituive e KD ndërpritet, derisa zgjedhjet apo emërimet të jenë përsëritur në mënyrë të suksesshme.

Neni 4

Pas verifikimit të mandatit, anëtarët e KD e nënshkruajnë deklaratën etike me sa vijon: "Deklaroj se do t'i kryej detyrat me nderë dhe besnikëri, me drejtësi dhe pa anim, se do të kontribuoj në përmbushjen e detyrave të Këshillit Drejtues, se do ta ushtroj mandatin tim me ndërgjegje dhe përgjegjësi, se do t'i përfaqësoj me ndërgjegje dhe përkushtim interesat e

S.A.

UShAF dhe se do t'i përmbahem Statutit të UShAF dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës".

III. ZGJEDHJA E KRYESUESIT DHE ZËVENDËSKRYESUESIT TË KD

Neni 5

- 1) Kryesuesi i KD zgjedhet nga radhët e anëtarëve të emëruar nga MASH me shumicën e votave të anëtarëve të KD.
- 2) Zëvendëskryesuesi zgjedhet nga radhët e anëtarëve të emëruar nga MASH me shumicën e votave të anëtarëve të KD.
- 3) Zgjedhja e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit bëhet me votim të fshehtë.
- 4) KD me shumicë të votave, me votim të hapur formon komisionin prej tre anëtarëve për mbarëvajtjen e procesit të votimit për kryesues dhe zëvendëskryesues.
- 5) Secili anëtar i KD ka të drejtë të propozoj një kandidat prej anëtarëve të emëruar nga MASH për t'u zgjedhur kryesues dhe zëvendëskryesues.
- 6) Propozimet për kryesues dhe zëvendëskryesues miratohen me votim të hapur nga shumica e anëtarëve të KD, për secilin kandidat veç e veç.
- 7) Dy propozimet me më së shumti vota fitojnë të drejtën për të kandiduar për kryesues dhe zëvendëskryesues.
- 8) Nëse kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi nuk zgjedhen në rrethin e parë të votimit, votimi përsëritet dhe nëse edhe në rrethin e dytë asnjë kandidat për kryesues dhe zëvendëskryesues nuk fitojnë shumicën e votave, KD propozon kandidatë të tjerë, sipas procedurës së njëjtë të përshkruar në pikën 5 dhe 6 të këtij neni.

IV. MBLEDHJET E KD

Neni 6

- 1) Mbledhjet e KD, i thërret dhe i kryeson kryesuesi i KD.
- 2) Në rast të mungesës ose largimit të kryesuesit nga mbledhja, mbledhjen e kryeson zëvendëskryesuesi. Nëse edhe kryesuesi edhe zëvendëskryesuesi nuk kanë mundësi të marrin pjesë në mbledhje ose largohen nga mbledhja, mbledhjen e KD e kryeson anëtari më i vjetër i KD që është prezent në mbledhje.
- 3) Në rast se për çfarëdo arsye KD mbetet pa kryesues dhe zëvendëskryesues, mbledhjet i thërret dhe i kryeson anëtari më i vjetër i KD, i zgjedhur nga Senati i UShAF deri në zgjedhjen e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit.
- 4) Kryesuesi i thërret mbledhjet sipas nevojës.
- 5) Në raste të jashtëzakonshme, mbledhjet thirren nga shumica e anëtarëve të KD.
- 6) Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të mbahen në çfarëdo kohe sipas procedurave të parapara. Rendi i ditës për këto mbledhje duhet të jetë i kufizuar me një pikë kryesore.
- 7) Gjatë mbledhjes së KD mund të vendoset për thirrjen e ndonjë mbledhjeje të ardhshme të KD. Në këto raste, anëtarët e KD që nuk janë të pranishëm duhet të ftohen posaçërisht.
- 8) Për mbajtjen e mbledhjeve të KD nevojitet kuorumi prej katër (4) anëtarëve.

S. A.

- 9) Rendi i ditës për takimet e KD propozohet nga kryesuesi, në pajtim me Rektoren. Në fillim të mbledhjes miratohet rendi i ditës me shumicën e votave të anëtarëve të KD.
- 10) Ndërprerja ose shtyerja e mbledhjes bëhet përmes votimit, me miratimin e shumicës së anëtarëve të KD.
- 11) Në rast të shkarkimit të kryesuesit dhe të zëvendëskryesuesit, anëtari më i vjetër i KD i zgjedhur nga Senati, e organizon procedurën e zgjedhjes së kryesuesit dhe të zëvendëskryesuesit pa vonesë në koordinim me MASH.
- 12) Mbledhjet e KD janë të mbyllura për publikun, përveç në rastet kur KD vendos ndryshe.
- 13) Anëtarët e KD do të ftohen më së paku 48 orë para mbledhjes. Ftesat bëhen me e-mail ose në çfarëdo forme tjetër teknike, me të cilën dërgesa dhe informimi janë të sigurtë.
- 14) Kryesuesi ka të drejtë në çfarëdo kohe që të ftojë në mbledhje ekspertë ose persona të tjerë.
- 15) Kryesuesi është i obliguar të thërrasë mbledhjen e KD, nëse këtë e kërkojnë shumica e anëtarëve të KD dhe nëse qëllimi është i arsyetuar me shkrim.
- 16) Nëse kryesuesi apo zëvendëskryesuesi i KD nuk i përgjigjet kërkesës së shumicës së anëtarëve të KD për thirrjen e mbledhjes brenda afatit prej tri ditësh, mbledhjen e thërret anëtari më i vjetër i KD, i zgjedhur nga Senati.

V. PJESËMARRJA NË MBLEDHJE DHE PËRFAQËSIMI

Neni 7

- 1) Të gjithë anëtarët e KD janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e KD.
- 2) Anëtarët e KD veprojnë të pavarur dhe nuk përfaqësojnë asnjë interes tjetër individual apo grupor.
- 3) Anëtarët e KD votojnë personalisht dhe nuk lejohet delegimi i votës.
- 4) Para se të fillojë mbledhja e KD, anëtarët do të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes, e cila është pjesë integrale e procesverbalit. Në rastet kur anëtarët e KD marrin pjesë në formë virtuale, pjesëmarrja e tyre në mbledhje do të konfirmohet me provcesverbalin e aprovuar në mbledhjen e radhës.
- 5) Anëtari i KD mund të mungojë nga mbledhja për shkaqe të arsyeshme.
- 6) Për mosardhje në mbledhje, anëtari i KD duhet ta njoftojë me kohë kryesuesin.
- 7) Rektori dhe Sekretari i Përgjithshëm janë anëtarë ex-officio të KD, pa të drejtë vote.
- 8) Me ftesë të KD, në takimet e KD mund të marrin pjesë edhe prorektorët, por pa të drejtë vote.
- 9) Kryesuesi i Parlamentit të Studentëve mund të marrë pjesë në mbledhjet e KD, pa të drejtë vote, kur trajtohen çështjet që kanë të bëjnë me studentët. Pjesëmarrja koordinohet paraprakisht me kryesuesin e KD.

Neni 8

- 1) Për një anëtar të KD, konsiderohet se ka konflikt interesi, në pajtim me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik të Kosovës dhe Statutit të UShAF, nëse bie ndesh me interesin e tij publik, familjar dhe operacional.

S.A.

- 2) Anëtari në konflikt interesi duhet ta lëshojë mbledhjen gjatë asaj kohe kur çështja diskutohet për të. Pas mbarimit të diskutimit të çështjes, anëtari ftohet që t'a vazhdoj mbledhjen.

VI. FILLIMI I MBLEDHJES DHE MIRATIMI I RENDIT TË DITËS

Neni 9

- 1) Kryesuesi hap mbledhjen, kryeson, dhe përfundon atë.
- 2) Për përgatitjen e materialeve për mbledhjen e KD, kujdeset kryesuesi në bashkëpunim me Rektorin, të cilët i ndihmon Sekretari i Përgjithshëm.
- 3) Mbledhjet e KD mbahen në formë fizike, në formë virtuale (online), përmes mjeteve audio-vizuale të përshtatshme të komunikimit në distancë dhe në formë të kombinuar (fizike dhe virtuale). Për formën e pjesëmarrjes në mbledhje të KD vendos vet anëtari. Nëse një anëtarë vendosë të merr pjesë në mbledhje në formë virtuale, për një gjë të tillë duhet ta njoftojë kryesuesin para fillimit të mbledhjes.
- 4) UShAF është i obliguar të sigurojë mundësinë e pjesëmarrjes së anëtarëve në mbledhje të KD në formë virtuale.
- 5) Në fillim të mbledhjes, kryesuesi konstaton se a ka kuorum, propozon rendin e ditës, hap diskutimin rreth rendit të ditës, konstaton miratimin e rendit të ditës.
- 6) Kryesuesi ia jep fjalën diskutuesit, konstaton mbylljen e shqyrtimit të temës së caktuar, çështjen e vë në votim, konstaton miratimin ose refuzimin e propozimit, ndërmer masa për sigurimin e mbarëvajtjes së punës në mbledhje, e konstaton përfundimin e mbledhjes pasi të jenë përfunduar të gjitha pikat e parapara në rendin e ditës, përveç në rastet kur me shumicën e votave të anëtarëve të KD vendoset ndryshe. Kryesuesi ndërmer veprime të tjera të nevojshme për udhëheqjen dhe drejtimin e mbledhjes, sipas kësaj Rregullore.
- 7) Anëtarët e KD kanë të drejtë të propozojnë ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës, duke e arsyetuar propozimin. Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës miratohet nga shumica e anëtarëve të KD.
- 8) Materialet ose kërkesat, të cilat bashkëngjiten gjatë mbledhjes, mund të miratohen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve me të drejtë vote.

VII. ECURIA E MBLEDHJES

Neni 10

- 1) Pas miratimit të rendit të ditës, kalohet në shqyrtim dhe vendosje për çështjet që janë në kuadër të pikave të miratuara të rendit të ditës.
- 2) Raportin dhe arsyetimin rreth secilës pikë të rendit të ditës, e paraqet kryesuesi ose personi i caktuar nga kryesuesi, pas të cilit kryesuesi e hap diskutimin.
- 3) Të gjithë anëtarët e pranishëm të KD mund të marrin pjesë në diskutim dhe t'i paraqesin mendimet, propozimet lidhur me çështjet, të cilat do të vendosen në mbledhje.

J.O.

- 4) Kryesuesi e jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim. Në mbledhjet e KD, askush nuk mund të diskutojë pa e marrë fjalën nga kryesuesi i mbledhjes.
- 5) Kryesuesi është përgjegjës për respektimin e Rregullores së Punës, për veprimet dhe sjelljen e anëtarëve sipas rendit.
- 6) Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë nga folësit që t'i përmbahen temës.

Neni 11

KD, në bazë të propozimit të kryesuesit apo të ndonjë anëtari të KD, me shumicë të votave mund të vendosë që shqyrtimi për disa çështje specifike të ndërpritet dhe të përgatitet më hollësisht për mbledhjen e ardhshme.

VIII. PARASHTRIMI I KËRKESAVE - ANKESAVE

Neni 12

- 1) Çdo anëtar i KD ka të drejtë të parashtrojë kërkesë - ankesë për temën e caktuar.
- 2) Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë që kërkesa - ankesa të parashtrohet me shkrim.

IX. VENDOSJA - VOTIMI DHE ZGJEDHJET

Neni 13

- 1) Vendimet e KD janë të plotfuqishme vetëm nëse kuorumi vërtetohet në kohën e votimit.
- 2) Para se të votohet, kryesuesi e formulon propozimin e vendimit ose të kërkesës lidhur me atë pikë të rendit të ditës.
- 3) Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve, sipas pikës së rendit të ditës, KD merr vendim ose konkluzion, sipas pikës së rendit të ditës.
- 4) KD merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të KD.
- 5) Nëse ka më shumë propozime të vendimeve ose të konkluzioneve, së pari votohet për ato në material ose për propozimet nga organet e UShAF, e pastaj për propozimet e tjera.
- 6) Votimi bëhet i hapur, me ngritje dore ose me vota të fshehta. Për mënyrën e votimit, KD vendos në mbledhjen përkatëse me shumicën e votave të anëtarëve të KD.
- 7) Votimi bëhet: "për", "kundër" dhe "abstenim".
- 8) Në rastet kur votimi bëhet me vota të fshehta, në votim nuk mund të marrin pjesë anëtarët të cilët marrin pjesë në mbledhje në formë virtuale.

Neni 14

- 1) Procedurën e votimit të fshehtë e zbaton komisioni i formuar nga KD, në përbërje prej tre anëtarëve.
- 2) Pas votimit, në bazë të rezultateve të votimit, kryesuesi i mbledhjes konstaton se propozimi i vendimit ose konkluzioni është miratuar ose është refuzuar.

Neni 15

Për vendimet e mëposhtme të KD, nevojitet shumica e kualifikuar e 2/3 të votave të anëtarëve të KD me të drejtë vote:

S.O.

- a) Për shkarkimin e rektorit;
- b) Për miratimin e planit vjetor financiar.

Neni 16

Votimi me vota të fshehta bëhet për:

- a) Zgjedhjen dhe shkarkimin e kryesuesit të KD;
- b) Zgjedhjen dhe shkarkimin e zëvendëskryesuesit të KD;
- c) Zgjedhjen dhe shkarkimin e rektorit;
- d) Inicimin për shkarkimin e dekanëve;
- e) Çështjet që kanë ndikim në çështjet private të ndonjërit prej anëtarëve të KD;
- f) Çështjet ku shumica e anëtarëve të KD kërkojnë votim të fshehtë.

Numërimi i votave për këto çështje bëhet në praninë e anëtarëve.

X. ZGJEDHJA E REKTORIT

Neni 17

- 1) Rektorin e zgjedh KD nga lista e kandidatëve të propozuar nga Komisioni Profesional, të cilin e formon Senati. Komisioni Profesional ka për detyrë që të verifikojë nëse kandidatët e paraqitur për pozitën e Rektorit i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs.
- 2) Rektori zgjedhet me votim të fshehtë nëpërmjet fletëvotimeve. Fletëvotimi do t'i përmbajë të gjithë kandidatët të cilët janë paraqitur për intervistim nga KD. Kandidatët të cilët nuk janë paraqitur për intervistim para KD, nënkupton se janë tërhequr nga gara për tu zgjedhur Rektor. Secili anëtar i KD ka të drejtë ta rrumbullaksojë një kandidat në fletëvotim. Fletëvotimet që kanë të rrumbullaksuar më shumë se një kandidat, do të konsiderohen të pavlefshme. Numri total i votave numërohet për secilin kandidat. Kandidati, i cili e arrinë shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të KD me të drejtë vote, zgjedhet Rektor.
- 3) Nëse asnjë kandidat nuk e arrinë shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve në radhën e parë, dy kandidatët me numër më të madh të votave kualifikohen në votimin e dytë.
- 4) Nëse asnjëri prej dy kandidatëve nuk arrinë shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, në tri radhë të njëpasnjëshme të votimit, procedura e zgjedhjes do të përsëritet nga fillimi, d.m.th. me shpalljen e konkursit për pozitën e Rektorit.
- 5) KD ka të drejtë të refuzojë listën e kandidatëve të propozuar nga Komisioni Profesional.

XI. ZGJEDHJA E PROREKTORËVE

Neni 18

- 1) Rektori e propozon listën e emrave për prorektorë, nga radhët e personelit akademik të UShAF.
- 2) Propozimet duhet të jenë të arsyetuara mirë dhe të përfshijnë edhe jetëshkrimin e kandidatit.

S. A.

- 3) Prorektorët zgjedhen nga KD, me shumicën e votave në një radhë votimi.
- 4) Nëse kandidati i propozuar nuk zgjidhet, atëherë rektori ka të drejtë ta propozojë kandidatin e ri, sipas procedurës së paraparë.

XII. MBAJTJA E RENDIT NË MBLEDHJE

Neni 19

- 1) Për mbajtjen e rendit në mbledhje kujdeset Kryesuesi.
- 2) Kryesuesi dhe pjesëmarrësit në mbledhjen e KD, janë të obliguar që t'i përmbahen kësaj Rregullore.

XIII. PROCEVERBALI NGA MBLEDHJA E KD

Neni 20

- 1) Në çdo mbledhje të KD mbahet procesverbal. Procesverbali nënshkruhet nga kryesuesi dhe nga procesmbajtësi.
- 2) Procesverbali duhet t'i përmbajë këto elemente:
 - a) Vendin, datën dhe kohën e fillimit dhe të mbarimit të mbledhjes;
 - b) Rendin e ditës;
 - c) Listën e pjesëmarrësve dhe të atyre që mungojnë;
 - d) Çështjet që u diskutuan dhe pretendimet e anëtarëve;
 - e) Vendimet që u morën;
 - f) Të gjitha propozimet, format dhe rezultatet e votimeve përkatëse;
 - g) Shënimet thelbësore mbi rrjedhën e mbledhjes.Dokumentet shtesë duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit si aneks.
- 3) Procesverbali duhet të përgatitet brenda një jave pas mbledhjes së KD dhe si ekstrakt duhet t'u dërgohet anëtarëve të KD me rastin e dërgimit të materialit për mbledhjen e ardhshme të KD.
- 4) Procesverbali miratohet në mbledhjen e ardhshme të KD.
- 5) Procesverbali ruhet në arkiv të UShAF me materialet shqyrtuese, sipas pikëve të rendit të ditës, si dokumente afatgjate.

XIV. PUNA E KOMISIONEVE

Neni 21

- 1) Komisionet janë organe ndihmëse të KD.
- 2) Komisionet formohen nga KD në pajtim me Statutin e UShAF dhe e ndihmojnë KD lidhur me çështjet e veçanta të punës së tij.

XV. AKTET E KD

Neni 22

- 1) KD nxjerr:
 - Rregullore;
 - Vendime;
 - Konkluzione;
 - Rekomandime.
- 2) KD jep interpretim autentik të akteve që miraton.
- 3) Procesmbajtësi është i obliguar që t'i përgatisë vendimet dhe rekomandimet nga mbledhja e KD, ndërsa Rregulloret i përgatit komisioni përkatës.

S.O.

Neni 23

Dispozitat e kësaj Rregulloreje vlejnë për të gjithë anëtarët e KD dhe personave të tretë të ftuar ose të angazhuar në procedurat e KD.

Neni 24

Për të gjitha çështjet, të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore, do të zbatohen dispozitat e Statutit të UShAF dhe Ligjit për Arsimin e Lartë.

XVI. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 25

- 1) Për zbatimin e drejtë të kësaj Rregullore, kujdeset Kryesuesi i KD.
- 2) Interpretimin autentik të kësaj Rregullore e jep KD.
- 3) Rregullorja hyn në fuqi në ditën e miratimit nga KD i UShAF.
- 4) Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja mbi punën e Këshillit të UShAF-it, nr. 172/16, e datës 19.02.2016.

Neni 26

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregullore bëhet sipas procedurës së njëjtë të miratimit të saj.


Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Prof. As. Dr. Samet Dalipi

